

1841
22.05.2017.

- Juri
- K. J. J.
- Ç. B. K.
22.05.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 5182 Prot.

Tiranë, më 18.05.2017

URDHËR

Nr. 271, datë 18.05.2017.

**“PËR
FILLIMIN E PROÇESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE
JASHTË RRADHE, PËR DISA AUTORITETE DREJTUESE, PËRGJEGJËS
DEPARTAMENTI, NË UNIVERSITETIN “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 131 të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 5 të nenit 5 të Rregullores së Zgjedhjeve Nr.2459/1, datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Fillimin e proçesit zgjedhor jashtë radhe, për disa autoritete drejtuese në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër, si më poshtë:
 - a. Përgjegjës i Departamentit të Administrim – Biznesit në Fakultetin Ekonomik;
 - b. Përgjegjës i Departamentit të së Drejtës Civile në Fakultetin e Drejtësisë;
 - c. Përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Gjermane në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja;
 - d. Përgjegjës i Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës;
 - e. Përgjegjës i Departamentit të Infermierisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.
 - f. Përgjegjës i Departamentit të Matematikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.
 - g. Përgjegjës i Departamentit të Arteve në Fakultetin e Shkencave të Edukimit.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet e mësipërme drejtuese, të jetë data 19.06.2017.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

